

1 E hënë, 9 nëntor 2020

2 [Paraqitja e Parë]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari Krasniqi hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 11.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjes të gjithëve  
7 brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Përpara se të fillojmë dhe në përputhje me vendimin për  
9 caktimin e datës së seancën së Paraqitjes së Parë, fotografi i  
10 gjykatës ka të drejtë të bëjë disa fotografi për një minutë e  
11 gjysmë.

12 Znj. fotografe, do të kërkoj prej jush që të mos bëni  
13 fotografi të z. Krasniqi me rojat e sigurisë përreth. Mund të  
14 vazhdoni.

15 Faleminderit znj. fotografe.

16 Znj. Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqitni lëndën.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Lënda numër KSC-BC-  
18 2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri  
19 Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit znj.  
21 Sekretare.

22 Përpara se t'u kërkoj të pranishmëve në sallë që të  
23 prezantohen, dua që të gjithëve t'u rikujtoj disa rregulla që  
24 duhen të respektohen gjatë gjithë kohës për ecurinë e  
25 papenguar të kësaj seance.

1 Ju lutem ndizeni mikrofonin përpara se të filloni të  
2 flisni dhe fikenë kur të përfundoni me të folur.

3 Flisni ngadalë dhe qartë, duke qenë se ajo që thuhet këtu  
4 përkthehet në shqip dhe serbisht.

5 Prisni pesë sekonda përpara se të më përgjigjeni mua, apo  
6 një pale, ose pjesëmarrësi në procedurë, në mënyrë që t'u  
7 mundësojmë përkthyesve të përfundojnë përkthimin.

8 Ajo që thuhet në këtë seancë transkribohet në kohë  
9 reale, dhe do të reflektohet në një procesverbal i cili do t'u  
10 vihet në dispozicion palëve dhe publikut pas kësaj seance.

11 Gjithashtu, dua t'i rikujtoj palët se një pjesë e  
12 informacionit në këtë çështje është objekt i urdhrave për masa  
13 mbrojtëse dhe konfidencialitet. Këtu përfshihet informacioni  
14 konfidencial që është redaktuar nga Aktakuza e Konfirmuar.  
15 Informacion në lidhje me identitetin e disa individëve, me  
16 disa data, vendndodhje dhe informacion tjetër identifikues.

17 Informacioni konfidencial nuk nxirret në seancë publike.  
18 Në qoftë se një palë, ose pjesëmarrës dëshiron ta bëjë këtë,  
19 atëherë duhet të kalojmë në seancë private dhe informacioni  
20 konfidencial mund t'i referohet vetëm në atë kontekst.

21 Tani do t'u kërkoj palëve të prezantohen. Do të filloj me  
22 Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

23 Z. TIEGER: [Përkthim] Mirëdita i nderuar Gjykatës dhe të  
24 gjithë të pranishmit këtu në sallë.

25 Në emër të Zyrës së Prokurorit të Specializuar të

1 pranishëm janë sot: Prokurori i Specializuar, Jack Smith;  
2 Zëvendësprokurori i Specializuar, Alex Whiting; shefja e Zyrës  
3 së Këshillimit Juridik, Clare Lawson; Prokurori, David Harbach  
4 dhe unë Alan Tieger, Prokuror i Lartë.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z.  
6 Prokuror.

7 Tani do t'i kthehem Mbrojtjes. Për publikun, dua që t'u  
8 informoj se avokati mbrojtës është me videolidhje i pranishëm  
9 nga Kuala Lumpur.

10 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Mirëdita.  
11 Unë jam Venkateswari Alagendra, avokate mbrojtëse e z. Jakup  
12 Krasniqi.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit znj.  
14 mbrojtëse. Në qoftë se gjatë kësaj seance keni problem teknik,  
15 atëherë ju lutem të bëni një shenjë me dorë, në mënyrë që të  
16 rregullojmë problemin dhe pastaj unë do ta ndërpres seancën,  
17 në mënyrë që të sigurojmë që ju do të jeni në gjendje të  
18 ndiqni procedurën gjatë gjithë kohës.

19 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim]  
20 Faleminderit.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Për hir të procesverbalit,  
22 theksoj se i pranishëm në sallë është edhe z. Krasniqi.

23 Tani ia jap fjalën Administratores.

24 ADMINISTRATORJA: [Përkthim] Mirëmëngjes i nderuar  
25 Gjykatës. Fidelma Donlon, Administratore.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

2 Dhe për procesverbalin, unë jam Nicolas Guillou, Gjykatës  
3 i Procedurës Paraprake në këtë çështje.

4 I akuzuari paraqitet sot për herë të parë para Dhomave të  
5 Specializuara pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij.

6 Z. Krasniqi, ngrihuni në këmbë ju lutem. A mund të thoni  
7 emrin dhe mbiemrin ju lutem?

8 I AKUZUARI KRASNIQI: Po. Unë jam Jakup Krasniqi.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Datën e lindjes dhe vendin  
10 e lindjes ju lutem?

11 I AKUZUARI KRASNIQI: Lindur më 1 janar 1951.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Shtetësia?

13 I AKUZUARI KRASNIQI: E Kosovës, kosovar.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit. Tani mund  
15 të uleni z. Krasniqi.

16 Tani do të kaloj në historikun procedural të kësaj  
17 çështje.

18 Më 26 tetor 2020, unë si Gjykatës i Procedurës Paraprake,  
19 konfirmova aktakuzën e parashtruar nga Prokurori i  
20 Specializuar kundër të akuzuarit që përfshin gjashtë akuza për  
21 krime kundër njerëzimit; përkatësisht, përndjekje, burgosje,  
22 akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje, dhe zhdukje me  
23 forcë e personave; dhe katër akuza për krime lufte;  
24 përkatësisht, ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë, dhe  
25 vrasje e paligjshme.

1 I akuzuari u arrestua në Kosovë më 4 nëntor 2020. Ai u  
2 transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të  
3 Specializuara të Kosovës në Hagë po atë ditë.

4 Z. Krasniqi, përpara se të vazhdojmë dua që të sigurohem  
5 se mund t'i ndiqni këto procedura në një gjuhë që e kuptoni  
6 dhe flisni. A mund ju lutem, të më konfirmoni që e flisni dhe  
7 e kuptoni gjuhën shqipe?

8 I AKUZUARI KRASNIQI: Unë jam shqiptar edhe e flas edhe e  
9 kuptoj mirë gjuhën shqipe.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z.  
11 Krasniqi.

12 Me këtë konfirmim jam i bindur se mund t'i ndiqni  
13 procedurat në shqip, në gjuhë pra, që e kuptoni dhe e flisni  
14 në përputhje me rregullën 92 të Rregullores së Procedurës dhe  
15 të Provave. Në qoftë se gjatë kësaj seance, në çfarëdo momenti  
16 nuk e dëgjoni përkthimin, atëherë ju lutem të ma bëni këtë me  
17 dije menjëherë.

18 Tani më lejoni që ta shpjegoj qëllimin specifik të  
19 seancës të Paraqitjes së Parë për nevojat e publikut, të të  
20 akuzuarit dhe atyre që na ndjekin nga galeria publike dhe  
21 online.

22 Seanca e sotme nuk është gjykim. Në këtë seancë nuk  
23 paraqiten dhe as debatohen prova, dhe as nuk diskutohet dhe as  
24 merret vendim në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e të  
25 akuzuarit. Qëllimi i kësaj seance rregullohet me nenin 39 të

1 Ligjit dhe rregullën 92 të Rregullores.

2 Sipas këtyre dispozitave, si Gjykatës i Procedurës  
3 Paraprake, e kam për detyrë t'ia lexoj të akuzuarit akuzat e  
4 përfshira në aktakuzë në një gjuhë që ai e flet dhe e kupton;  
5 të konfirmoj se i akuzuari e kupton aktakuzën; të bindem se  
6 janë respektuar të drejtat e të akuzuarit, sidomos e drejta e  
7 tij për të pasur një mbrojtës; ta informoj të akuzuarin se  
8 brenda 30 ditësh nga seanca e sotme, ai do të ftohet që të  
9 vetëdeklarohet lidhur me secilën pikë për fajësi, ose  
10 pafajësi, në lidhje pra, me secilën pikë të aktakuzës. Nëse  
11 dëshiron këtë, i akuzuari mund ta bëjë edhe menjëherë.

12 Dhe në fund, do t'i caktoj të gjitha datat e tjera, sipas  
13 rastin, në kryerjen e detyrave të mia si Gjykatës i Procedurës  
14 Paraprake. Kërkoj prej palëve që t'u përmbahen këtyre pikave  
15 të cilat do t'i trajtojmë një nga një. Në qoftë se ndonjëra  
16 prej palëve ka për të ngritur ndonjë çështje që nuk është  
17 paraparë brenda kuadrit të kësaj seance, atëherë këtë mund ta  
18 bëjë me shkrim, duke nxjerrë parashtime me shkrim para meje.

19 Z. Krasniqi, a mund t'ju lutem të më konfirmoni se e keni  
20 marrë, apo ju është dhënë Aktakuza e Konfirmuar e datës 4  
21 nëntor 2020, në gjuhën që e flisni dhe e kuptoni?

22 I AKUZUARI KRASNIQI: Po. Aktakuzën e kam marrë. Edhe një  
23 pjesë të saj edhe më 4 nëntor 2020, por edhe pasi kemi ardh në  
24 burgun e Hagës e kemi marrë një variant të korrigjuar, ose të  
25 përmirësuar të aktakuzës. Dhe është në gjuhën shqipe dhe e kam

1 kuptuar mirë dhe e kam lexuar mirë.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z.

3 Krasniqi.

4 Tani do të kërkoj nga Sekretarja që t'i lexojë akuzat e  
5 parashtuara në Aktakuzën e Konfirmuar, sikurse kërkohet me  
6 rregullën 92 të Rregullores dhe nenin 39 të Ligjit.

7 Urdhëroni.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: Ju faleminderit.

9 1. Në Aktakuzën e Konfirmuar, Prokurori i Specializuar  
10 akuzon z. Jakup Krasniqi për:

11 Pika 1: Përndjekje, krim kundër njerëzimit i ndëshkueshëm  
12 në bazë të nenit 13(1)(h) të Ligjit;

13 Pika 2: Burgosje, krim kundër njerëzimit i ndëshkueshëm  
14 në bazë të nenit 13(1)(e) të Ligjit;

15 Pika 3: Ndalim arbitrar, krim lufte i ndëshkueshëm në  
16 bazë 14(1)(c) të Ligjit;

17 Pika 4: Akte të tjera çnjerëzore, krim kundër njerëzimit  
18 i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(j) të Ligjit;

19 Pika 5: Trajtim mizor, krim lufte i ndëshkueshëm në bazë  
20 të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

21 Pika 6: Torturë, krim kundër njerëzimit i ndëshkueshëm në  
22 bazë të nenit 13(1)(f) të Ligjit;

23 Pika 7: Torturë, si krim lufte i ndëshkueshëm në bazë të  
24 nenit 14(1)(c)(1) të Ligjit;

25 Pika 8: Vrasje, krim kundër njerëzimit i ndëshkueshëm në

1 bazë të nenit 13(1)(a) të Ligjit;

2 Pika 9: Vrasje e paligjshme, si krim lufte i ndëshkueshëm  
3 në bazë të nenit 14(1)(c)(1) të Ligjit; dhe

4 Pika 10: Zhdukje me forcë e personave, krim kundër  
5 njerëzimit i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(i) të Ligjit.

6 2. Këto krime u kryen midis afërsisht prillit 1998 dhe  
7 gushtit 1999, në një numër vendndodhjesh në Kosovë dhe në  
8 Shqipërinë veriore, ndër të cilat:

9 a. Bare, Bajgorë, Llapashticë, Majac, Potok dhe vende të  
10 tjera në komunën e Podujevës; Drenoc dhe vende të tjera në  
11 komunën e Rahovecit; Malet e Berishës, Llapushnik dhe vende të  
12 tjera në komunën e Drenasit; Ferizaj dhe vende të tjera në  
13 komunën e Ferizajt; Gjilan në komunën e Gjilanit; Jabllanicë  
14 në komunën e Gjakovës; vende në komunën e Kaçanikut; Kleçkë  
15 dhe vende të tjera në komunën e Lipjanit; Likoc dhe vende të  
16 tjera në komunën e Skënderajt; Malishevë dhe vende të tjera në  
17 komunën e Malishevës; në Shpellën e Volljakës në komunën e  
18 Klinës; Novobërdë në komunën e Novobërdës; Zllash dhe vende të  
19 tjera në komunën e Prishtinës; Prizren dhe vende të tjera në  
20 komunën e Prizrenit; Suharekë dhe vende të tjera në komunën e  
21 Suharekës; dhe vendndodhje në komunën e Vitisë; dhe

22 b. Cahan dhe Kukës në Shqipërinë veriore.

23 3. Krimet në pikat 1, 2, 4, 6, 8 dhe 10 u kryen si pjesë  
24 e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik të drejtuar  
25 kundër popullatës civile në Kosovë dhe në Shqipërinë veriore,

1 duke filluar prej së paku marsit 1998 e deri në shtator të  
2 vitit 1999. Në veçanti, këto krime kishin në shënjestër  
3 kundërshtarë të cilët perceptoheshin se kishin bashkëpunuar,  
4 ose kishin lidhje me forca, zyrtarë, ose institucione  
5 shtetërore të Republikës Federale të Jugosllavisë, ose  
6 ndryshe, nuk përkrahnin qëllimet dhe metodat e Ushtrisë  
7 Çlirimtare të Kosovës dhe më pas të Qeverisë së Përkohshme të  
8 Kosovës, duke përfshirë edhe persona që kishin lidhje me  
9 Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe persona të përkatësisë  
10 etnike serbe, rome, dhe të përkatësive të tjera etnike.

11 4. Krimet në pikat 3, 5, 7 dhe 9 u kryen kundër personave  
12 që nuk merrnin pjesë aktive në luftime, dhe në kontekstin, dhe  
13 në lidhje me konfliktin e armatos jondërkombëtar në Kosovë  
14 midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së, Republikës së Serbisë,  
15 ndër të cilat njësitet të Ushtrisë Jugosllave, njësitet policore  
16 dhe njësitet të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe  
17 grupe të tjera që luftonin në emër të RFJ-së dhe Serbisë, nga  
18 së paku marsi i vitit '98-të e deri më afërsisht 16 shtator  
19 1999.

20 5. Në lidhje me këto krime, ekziston dyshim i bazuar mirë  
21 se z. Krasniqi është penalisht përgjegjës në bazë të nenit  
22 16(1)(a) të Ligjit për:

23 a. Kryerjen, si anëtar i ndërmarrjes kriminale të  
24 përbashkët, të krimeve në pikat 1 deri në 10, ose në  
25 alternativë, kryerjen e ndërmarrjes kriminale të përbashkët të

1 lartpërmendur të krimeve në pikat 1, 10, duke qenë i  
2 vetëdijshtëm se këto krime mund të kryheshin gjatë zbatimit të  
3 qëllimit të përbashkët të ndërmarrjes kriminale të përbashkët,  
4 dhe duke e ndërmarrë këtë rrezik me vullnet të lirë; dhe

5 b. Për ndihmimin dhe inkurajimin e krimeve në pikat 1  
6 deri në 10.

7 6. Gjithashtu, dhe në alternativë ekziston dyshim i  
8 bazuar mirë se z. Krasniqi është penalisht përgjegjës, në bazë  
9 të nenit 16(1)(c) të Ligjit, si epror për krimet në pikat 1  
10 deri në 10.

11 Ju faleminderit i nderuar Gjykatës.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.

13 Sekretare.

14 Z. Krasniqi, desha t'ju kujtoj se sot nuk është dita për  
15 të kontestuar akuzat, por thjesht për të pranuar se i keni  
16 kuptuar akuzat. Do të keni mundësi të bollshme që t'i  
17 kundërshtoni akuzat me ndihmën e avokates tuaj.

18 Z. Krasniqi, a i kuptuat akuzat e përfshira në Aktakuzën  
19 e Konfirmuar që jua lexoi Sekretarja e Gjykatës?

20 I AKUZUARI KRASNIQI: Unë dua të them disa, dy, tri  
21 çështje, dhe do të përpiqem që t'i them goxha shkurtër.

22 Së pari, dua të them këtu se unë jam arrestuar më 4  
23 nëntor 2020. Në Aktakuzë po na quani ndërmarrje kriminale të  
24 përbashkët. Unë dua të deklaroj sot se kurrë në jetën time, në  
25 asnjë rast të vetëm nuk i kam trajtuar njerëzit as kaq sa e si

1 më trajtuat mua nga ndërtesa e burgut deri në këtë ndërtesë. E  
2 theksoj, kurrë në jetën time s'kam trajtuar njerëz në këtë  
3 mënyrë, se s'ka qenë qëllimi im trajtimi i njerëzve po lufta  
4 kundër okupatorit që ka bë krime të gjenocidit në Kosovë.  
5 Prandaj e ndiej vehten më shumë se mirë, dhe kurrë nuk do të  
6 dëshiroja të jem në petkun e njerëzve që kanë shpirt  
7 kriminel.

8 Unë jam intelektual, jam njeri që politikisht e kam  
9 luftuar Serbinë. Kurrë në asnjë deklaratë time nuk e kam  
10 orientuar gishtin nga popullsia civile, as serbe, as ndonjë  
11 tjetër.

12 Mandej, në Aktakuzë përpigëni t'i ndani shqiptarët në  
13 katolikë dhe myslimanë. Unë jam shqiptar, s'jam as katolik as  
14 mysliman. Edhe kjo për mua është fyese, edhe për mu edhe për  
15 vendin tim.

16 Më lejoni tash t'i them disa çështje për Aktakuzën.

17 Se cilësimi i Prokurorit të Dhomave të Specializuara se  
18 ne qenkemi ndërmarrje kriminale e përbashkët, për mua, shokët  
19 e mi, familjen time që luftuam gjatë, por edhe për kombin  
20 tonë, nuk ka diçka më fyese, pasi ne një kohë të gjatë, në  
21 rrethana tepër të vështira jete a vdekje, u vumë në shërbim të  
22 lirisë e të shtetndërtimit, të cilat i arritëm në bashkëveprim  
23 me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me vendet e Bashkimit  
24 Evropian, me NATO-n, me OKB-në, dhe të gjithë së bashku ishim  
25 dhe jemi ndërmarrje e përbashkët çlirimtare dhe shtetformuese.

1 Ndërsa, ndërmarrje e përbashkët kriminale janë jo vetëm serbët  
2 në Serbi, ishte dhe është këmbë e krye vetëm koka e saj në  
3 Beograd, vetëm mbështetësit e politikave të Beogradit.

4 Besoj dhe besoj shumë që këtë e din secili qytetar i  
5 arsimuar që së paku është mbi 30 vjeç, vjeçar, e jeton në  
6 vendet e demokracive perëndimore. Aty ku janë rritur e edukuar  
7 me vlerat e kësaj bote që veçohet me vlerat që kanë të bëjnë  
8 me të drejtat dhe liritë e njeriut.

9 Unë sot s'du të zgjatem më shumë, po due t'u them që unë  
10 kam qenë i dënuar nga regjimet kriminale të Jugosllavisë në  
11 vitin 1981 dhe 1982. Dhe ata më kanë pas dënuar pse kam lexuar  
12 libra, pse kam fol dhe pse e kam kundërshtuar atë regjim. Po  
13 besoni, më shumë të drejtë kanë pas ata atje sesa sot që  
14 gjindem këtu.

15 Për mua është bë një padrejtësi e madhe dhe do ta mbaj  
16 dhe këtë padrejtësi. Se populli ynë e ka një fjalë, thotë:  
17 "Njeri është më i fortë se guri". Dhe atë që se mban guri, e  
18 mban njeriu.

19 Unë dhe populli im ka mbajjt shumë padrejtësi dhe nuk kemi  
20 pas nevojë për njikët padrejtësi.

21 Natyrisht në seancat e tjera unë do të them edhe më  
22 shumë, veç s'do ta ndihsha veten mirë të isha në shërbim të  
23 politikave të krimit dhe gjenocidit të Serbisë për të cilat  
24 edhe prokurori serb Vukçeviçi këto dita tha pasi është ngrit  
25 aktakuza, që ka qenë prokuror nga viti 2003.

1 Unë mendoj që adresa e qartë e krejt kësaj maskarade  
2 është në Beograd dhe te mbështetësit e politikave të saj kudo  
3 qofshin ato.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë z.  
5 Krasniqi.

6 Tani t'ju informoj për të drejtat tuaja para kësaj  
7 gjykate.

8 Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Rregullorja e  
9 Procedurës dhe e Provave ju garantojnë një numër të drejtash  
10 dhe unë do t'ju lexoj disa më të rëndësishmet.

11 Së pari, ju do të prezumoheni i pafajshëm deri sa të  
12 vërtetohet fajësia përtej dyshimit të arsyeshëm. Në  
13 përcaktimin e akuzave kundër jush, keni të drejtën e një  
14 gjykimi të drejtë dhe publik në varësi të masave që mund të  
15 urdhërohen për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave.

16 Ju keni të drejtën të informoheni pa vonesë dhe në  
17 hollësi, në një gjuhë që e kuptoni, për natyrën dhe arsyet e  
18 akuzave që janë ngritur kundër jush.

19 Keni të drejtën që të keni kohë dhe mjete të mjaftueshme  
20 për përgatitjen e mbrojtjes tuaj dhe të komunikoni me avokatin  
21 që e keni zgjedhur vetë.

22 Keni të drejtën që të gjykoheni brenda një kohe të  
23 arsyeshme.

24 Keni të drejtën të gjykoheni në praninë tuaj dhe të  
25 mbroheni përmes avokatit tuaj.

1 Keni të drejtën t'ju caktohet mbrojtës avokat, dhe pa  
2 pagesë në qoftë se nuk keni mjete të mjaftueshme për të paguar  
3 për të.

4 Keni të drejtë t'i bëni pyetje, ose që dikush t'i bëj  
5 pyetje në emrin tuaj dëshmitarëve kundër jush, dhe të kërkon  
6 paraqitjen dhe marrjen në pyetje në dëshmitarëve në emrin  
7 tuaj.

8 Keni të drejtën e ndihmës pa pagesë të një përkthyesi në  
9 qoftë se nuk e kuptoni gjuhën që flitet në gjykatë.

10 Keni të drejtën që të mos detyroheni të dëshmoni kundër  
11 vetes, ose të pranoni fajësinë.

12 Keni të drejtën të qëndroni i heshtur, dhe nuk do të  
13 nxirret asnjë përfundim negativ nga heshtja juaj.

14 Po kështu, keni të drejtën të bëni deklaratë pa betim në  
15 lidhje me çështjen tuaj dhe ju mund të paraqiteni si dëshmitar  
16 nën betim.

17 Keni të drejtën të bëni mocione paraprake për të  
18 kundërshtuar juridiksionin e Dhomave të Specializuara. Të  
19 pretendoni të meta apo defekte në formën e aktakuzës dhe të  
20 kërkon veçimin e akuzave në aktakuzë.

21 Keni të drejtën që brenda 30 ditësh nga dita e sotme, të  
22 merrni materialet mbështetëse të Aktakuzës që janë dorëzuar --  
23 që është dorëzuar për konfirmim.

24 Keni të drejtën që t'i merrni që të gjitha deklaratat e  
25 dëshmitarëve që Prokurori i Specializuar ka ndërmend t'i

1 thërrasë për të dëshmuar në gjyq në gjuhë që ju e flisni dhe e  
2 kuptoni pra, në shqip.

3 Keni të drejtën të merrni menjëherë çfarëdo informacioni  
4 që mund të sugjerojë në mënyrë të arsyeshme pafajësinë tuaj,  
5 ose të lehtësojë fajësinë, ose që të ndikojë në besueshmërinë  
6 e dëshmive, e provave të Dhomave -- të Prokurorit të  
7 Specializuar, sa më shpejt që ky informacion të jetë në  
8 ruajtje, kontroll apo dijeninë e tij.

9 Keni të drejtë që të gjitha materialet dhe provat, ose  
10 faktet që ka Prokurori i Specializuar, t'ju vihen në  
11 dispozicion para fillimit dhe gjatë procesit të procedurës.  
12 Dhe kjo është e drejtë që është objekt i kufizimeve që janë  
13 rreptësisht të domosdoshme kur zbatohen masa mbrojtëse  
14 kundërbalancuese.

15 Keni të drejtë që të mos mbaheni në paraburgim për një  
16 periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes. Të kërkon  
17 rishikimin e vendimit të paraburgimit dhe t'i apeloni këto  
18 vendime në Gjykatën e Apelit.

19 Keni të drejtën të apeloni drejtpërsëdrejti në Gjykatën e  
20 Apelit, apo të bëni mocione paraprake që kundërshtojnë  
21 juridiksionin e Dhomave të Specializuara.

22 Keni të drejtën të kërkon të bëni -- të kërkon leje për  
23 apel kundër të gjitha vendimeve.

24 Z. Krasniqi, ju i dëgjuat të gjitha të drejtat më të  
25 rëndësishme që gëzoni në kuadrin ligjor të Dhomave të

1 Specializuara. A i kuptoni këto të drejta?

2 I AKUZUARI KRASNIQI: Po i kuptoj. Po dua të them diçka  
3 për Mbrojtjen. Realisht, unë fillimisht nuk kam menduar që të  
4 marr avokat mbrojtës, dhe atë nuk e kam marr me vullnetin tim,  
5 as me bindjen time se më duhet avokati, po ishte dëshira e  
6 familjes dhe e shokëve që të kem avokat, dhe e pranova. Po  
7 përndryshe jam i bindur që nuk më duhet avokati.

8 Nuk mbaj asnjë përgjegjësi të vetme me këtë që akuzohem,  
9 as të veprimit, as të mosveprimit.

10 Detyra ime ka qenë publike. Kryesorja ka qenë zëdhënës i  
11 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Unë kam pas detyra edhe pas  
12 luftës, kam qenë ministër, kam qenë dy mandate Kryetar i  
13 Kuvendit, po detyra që më ka flejt më së shumti në shpirt ka  
14 qenë e zëdhënësit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

15 E di që se kam nevojën ta them këtu, po po du me thënë që  
16 unë e kam -- gjithçka që e kam bërë ka qenë publike. Ka qenë  
17 publike jo vetëm në gjuhën shqipe, ka qenë publike edhe në  
18 gjuhën gjermane, edhe në gjuhën angleze, edhe në gjuhën  
19 frënge, edhe në gjuhën italiane. Unë kam qenë zëdhënës, i kam  
20 dha zë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që ka qenë  
21 tepër e vështirë dhe në rrethana tepër të vështira. Po  
22 megjithatë, ishim të vendosur që kishim të drejtë të luftojmë  
23 për liri, dhe natyrisht në sajë të asaj të drejtës e fituam  
24 dhe mbështetjen ndërkombëtare, pa të cilën ne nuk do ta  
25 çlironim Kosovën, pa të cilën ne nuk do ta formonim shtetin,

1 Republikën e Kosovës. Unë jam i vetëdijshëm për këtë.

2 Por veprat të cilat pretendon Aktakuza, asnjëra nga ato  
3 nuk qëndron. Dhe unë në vitet, në muajt në vazhdim, sigurisht  
4 që do të ofroj edhe fakte konkrete, dhe ka fakte konkrete. Po  
5 nëse dikush pretendon se unë e kam fol edhe kundër Dhomave të  
6 Specializuara, e shoh të nevojshme ta them, unë në dhjetorin e  
7 vitit 2010 kur...

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Krasniqi, do të keni  
9 kohë të bollshme t'i diskutoni këto gjëra më vonë.

10 Vetëm për këtë ju pyeta për këtë moment, a i keni kuptuar  
11 të drejtat tuaja?

12 I AKUZUARI KRASNIQI: Z. Gjykatës, unë kam -- po du me  
13 thënë se jam tepër i mllëfosur, se e them edhe njëherë me  
14 bindje, këtu gjindem pa të drejtë edhe ndaj meje është bë  
15 padrejtësi e madhe.

16 Sikur vetëm një faj ta kisha, ai që më ngarkohet në  
17 Aktakuzë, unë do të ndihesha veten të turpëruar. Prandaj  
18 reagimi im është në këtë, jam këtu pa të drejtë. Unë duhet të  
19 jem në vendin tim, në familjen time.

20 Nuk mbaj asnjë përgjegjësi që të tjerët, apo dikush  
21 tjetër, unë mendoj që dhe ka këtu teprime, por unë nuk ndiej  
22 asnjë përgjegjësi të vetme dhe padrejtësia ndaj meje është  
23 tepër e madhe.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Krasniqi.

25 Tani më lejoni të them diçka lidhur me avokatin mbrojtës

1     tuajin.

2             Do të dua t'ju informoj që në përputhje me nenin 21(5) të  
3     Ligjit, ju nuk mund ta përfaqësoni veten sepse aktualisht jeni  
4     në ndalim, kështu që përfaqësimi nga një avokat mbrojtës është  
5     i detyrueshëm.

6             Është detyra ime si gjykatës i procesit, i Seancës  
7     Paraprake, që të sigurohem që e drejta për avokat mbrojtës për  
8     juve të respektohet. Për këtë arsye, unë i kam dhënë, e kam  
9     njoftuar Zyrën e Administratorit sa i takon caktimit të  
10    avokatit.

11            Juve në fakt sapo na e konfirmuat që keni avokat,  
12    megjithëse thatë që në fillim nuk kishit ndërmend që të merrni  
13    një avokat mbrojtës.

14            A mund t'ju pyes në qoftë se jeni caktuar për të  
15    përfaqësuar z. Krasniqi, znj. Gjyqtare?

16            ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Po, i  
17    nderuar z. Gjyqtar, po.

18            GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Krasniqi, nuk e di, a  
19    keni ndonjë gjë tjetër për të thënë sa i takon avokatit  
20    mbrojtës tuaj?

21            I AKUZUARI KRASNIQI: [Nuk dëgjohet]...duar, besoj që do  
22    të bisedojmë edhe në të ardhmen.

23            Unë e thashë që fillimisht nuk kam dëshiruar, po me  
24    presionin e familjes dhe të shokëve kam pranuar që të kem  
25    avokat. Megjithatë, në këtë rrafsh po i respektojmë procedurat

1 e Dhomave të Specializuara.

2 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Krasniqi.

3 Jam i kënaqur që i akuzuari është i përfaqësuar nga  
4 avokati mbrojtës.

5 Tani do të doja t'i jepja mundësinë të akuzuarit që të  
6 vetëdeklarohet në qoftë se dëshiron, në përputhje me rregullën  
7 92.

8 Z. Krasniqi, brenda 30 ditëve nga dita e sotme, do t'ju  
9 kërkohet që të vetëdeklaroheni fajtor, ose jo fajtor për  
10 secilën nga pikat e Aktakuzës së Konfirmuar. Megjithatë, në  
11 qoftë se dëshironi që të vetëdeklaroheni sot, mund ta bëni  
12 këtë gjë pra, të deklaroheni ose fajtor, ose jo fajtor.

13 Si rezultat do të doja t'ju kërkoja z. Krasniqi, dhe do  
14 të doja t'ju pyesja në qoftë se keni pasur mundësi që të  
15 diskutoni akuzën në Aktakuzën e Konfirmuar me avokatin  
16 mbrojtës, dhe në qoftë se jeni i përgatitur që të  
17 vetëdeklaroheni në këtë moment? Në qoftë se është ky rasti, do  
18 ju kërkoja që të ngriheshit në këmbë dhe të vetëdeklaroheshit.

19 I AKUZUARI KRASNIQI: Unë edhe pse e kam pasur një bisedë  
20 dje me avokaten mbrojtëse dhe i kemi shikuar telegrafikisht  
21 edhe pikat kryesore të Aktakuzës.

22 Unë edhe më herët e thashë dhe po e them, unë nuk ndihem  
23 fajtor e as përgjegjës për asnjë pikë që thuhet në Aktakuzë  
24 dhe për asnjë gjë tjetër që thuhet në Aktakuzë.

25 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Sa për ta sqaruar z.

1 Krasniqi, sepse nuk e di në qoftë se janë fjalët tua, ose në  
2 qoftë se është çështje përkthimi.

3 Pra, ju nuk ndiheni fajtor. Në qoftë se -- ju lutem na  
4 thoni në qoftë se vetëdeklaroheni jo fajtor, apo dëshironi që  
5 të bëjmë një tjetër seancë formale pas 30 ditëve për t'u  
6 vetëdeklaruar fajtor ose jo? D.m.th., ju thatë që nuk ndiheni  
7 fajtor, a vetëdeklaroheni fajtor apo jo z. Krasniqi? Kjo është  
8 pyetja.

9 I AKUZUARI KRASNIQI: Unë deklarohej jo fajtor. Nuk kam  
10 asnjë faj të vetëm. Nuk di si ta them ndryshe.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Krasniqi.  
12 Është shumë e qartë. D.m.th., thjesht jua bëra edhe një herë  
13 pyetjen në mënyrë që të ishte shumë e qartë në procesverbal që  
14 juve vetëdeklaroheni jo fajtor.

15 Faleminderit dhe mund të zini vend z. Krasniqi.

16 Tani le të kalojmë te gjuhët zyrtare të proceseve  
17 gjyqësore.

18 Në programin për këtë Seancë Paraprake, unë iu kërkoja  
19 palëve që të bënin parashtrimet e tyre në gjuhët zyrtare të  
20 cilat do të përdoren në çështjen në fjalë, në përputhje me  
21 rregullën 8.

22 Do të dua së pari t'i jap fjalën Prokurorit të  
23 Specializuar.

24 Z. TIEGER: [Përkthim] Faleminderit. Nuk ka nevojë për  
25 depozitime të tjera më të elaboruara. Nuk shikojmë asnjë arsye

1 për t'u larguar nga praktika që kemi krijuar deri tani, dhe me  
2 fjalë të tjera d.m.th., kjo përmbledh depozitimet tona për  
3 përdorimin e anglishtes si gjuhën e punës së këtij  
4 institucioni.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.  
6 Avokatja mbrojtëse, çfarë keni për të thënë ju lidhur me  
7 këtë pyetje?

8 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Jemi  
9 dakord, jemi dakord që anglishtja të jetë gjuha e punës e  
10 proceseve gjyqësore përpara Dhomave të Specializuara.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë znj.  
12 mbrojtëse.

13 Unë do të nxjerr një urdhër në kohën e duhur për këtë  
14 çështje.

15 Siç është thënë edhe në urdhrin sa i takon kësaj  
16 Paraqitje të Parë, unë do të planifikoj Konferencën e  
17 Statusit, në përputhje me rregullën 96, që do të mbahet  
18 menjëherë pas Paraqitjes së Parë. Qëllimi kryesor do të jetë  
19 që të rishikohet statusi apo gjendja e çështjes, të  
20 organizohen shkëmbime ndërmjet palëve, si dhe të sigurohen  
21 përgatitje të shpejta për këtë proces.

22 Z. Krasniqi, dua t'ju kujtoj që keni të drejtë që të  
23 merrni pjesë në Konferencat e Statusit së bashku me Mbrojtjen  
24 tuaj. Megjithatë, me pëlqimin me shkrim dhe pas marrjes së  
25 këshillimeve nga avokatja juaj, në përputhje me rregullën

1 996(2), Konferenca e Statusit mund të merret d.m.th., në  
2 Konferencën e Statusit mund të merrni pjesë juve personalisht  
3 së bashku me avokatin mbrojtës përmes lidhjes së  
4 videokonferencës, ose mund të merret pjesë -- mund të ndiqet  
5 prej jush z. Krasniqi, duke marrë pjesë përmes  
6 videokonferencës, ose mund të marrë pjesë edhe në mungesën  
7 tuaj z. Krasniqi, por me avokaten tuaj që do të marrë pjesë  
8 përmes lidhjes me videokonferencë.

9 Do të doja t'u kërkoja palëve që të shprehen lidhur me  
10 një datë të përshtatshme për Konferencën e Statusit që do të  
11 mbahet, ose më 18 nëntor, ose pas kësaj date.

12 Do të doja të pyes në qoftë se avokatja mbrojtëse do të  
13 marrë pjesë përmes videokonferencës, apo në mënyrë të  
14 drejtpërdrejtë.

15 Por së pari, më lejoni t'i jap fjalën Prokurorit.

16 Z. TIEGER: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne jemi të  
17 disponueshëm në atë datë edhe është një datë shumë e  
18 përshtatshme për ne.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Avokate mbrojtëse, a mund  
20 të na thoni në qoftë se kjo datë është e përshtatshme për  
21 juve, dhe a do të merrni pjesë vetë personalisht apo përmes  
22 lidhjes së videokonferencë?

23 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] I nderuar  
24 Gjykatës, ne kërkojmë 30 ditë minimumi për Konferencën e  
25 Statusit. Dhe dua që të udhëtoj nga Malajzia, dhe plani është

1 që të jem fizikisht e pranishme në sallën e gjyqit, me  
2 përjashtim të rasteve kur mund të ndodh ndonjë gjë madhore për  
3 të cilën nuk kam kontroll.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.  
5 mbrojtëse. Kam frikë se nuk kemi mundësi që të presim kaq  
6 gjatë, për shkak të detyrimeve të nxjerrjes nga Prokurori.

7 Në qoftë se -- nuk e di nëse keni ndonjë datë që mund të  
8 funksionojë, të ndryshme nga data që na dhatë më përpara? Kjo  
9 është pyetja e parë. Dhe pyetja e dytë është që, unë e di që  
10 ju merrni pjesë përmes konferencës, videokonferencës, dhe ka  
11 dallime le të themi, në orare në të dy vendet, kështu që mund  
12 të më thoni se kur do të ishte ndoshta një moment më i  
13 përshtatshëm për juve për të planifikuar Konferencës e  
14 Statusit?

15 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Unë do të  
16 jem e disponueshme në momentin dhe në kohën që përcaktohet  
17 prej jush si momenti më i përshtatshëm, qoftë koha gjatë ditës  
18 apo data e Konferencës së Statusit.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë znj.  
20 avokate. E vlerësojmë shumë, dhe duke pasur parasysh  
21 diferencën në orarin ndërmjet vendeve do të mundohemi që të  
22 mos e caktojmë shumë vonë gjatë ditës.

23 Pra, siç e dini, kemi skuadra të ndryshme mbrojtje dhe  
24 vërtetë e vlerësojmë fleksibilitetin tuaj mbi çështjen.

25 Do të merrni një urdhër për agjendën dhe për

1 planifikimin. Do ju kërkoj gjithashtu edhe palëve për  
2 depozitimet me shkrim për Konferencën e Statusit. Synoj që  
3 datën ta përcaktoj deri të premten më datë 13 nëntor, dhe për  
4 Mbrojtjen të martën më datë 17, por çdo gjë do ta merrni me  
5 shkrim.

6 Pas Konferencës së Statusit, do të nxjerr një vendim për  
7 detyrimin për nxjerrjen e informacionit të Zyrës së Prokurorit  
8 të Specializuar, në përputhje me rregullën 102 dhe regjimin e  
9 censurimit të proceseve gjyqësore.

10 Në këtë pikë do të doja t'u kërkoja palëve në qoftë se  
11 kanë ndonjë tjetër çështje që dëshirojnë të ngrenë, dhe do të  
12 doja që t'u kërkoja palëve që në qoftë se do të japin  
13 informacion konfidencial në ndërhyrjet e tyre, të na e bëjnë  
14 këtë me dije, në mënyrë që të marrim masat e nevojshme.

15 Z. Prokuror, fjala për juve.

16 Z. TIEGER: [Përkthim] Nuk kemi asgjë nga ana e  
17 Prokurorit z. Gjyqtar.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

19 Mbrojtja?

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Unë  
21 kërkoj që dokumentet kryesore ligjore të Zyrës së Prokurorit  
22 të Specializuar të mund t'i vihen në dispozicion z. Krasniqi  
23 në gjuhën e tij, dhe kemi si synim që të bëjmë një depozitim  
24 për lirimin paraprak, ose me kusht, sa më shpejt të jetë e  
25 mundur z. Gjykatës.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë. Kjo u  
2 mor shënim.

3 Z. Krasniqi, dua t'ju pyes ju në qoftë se keni ndonjë  
4 çështje për të ngritur, që ka të bëjë me arrestimin,  
5 transferimin, ose ndalimin tuaj?

6 I AKUZUARI KRASNIQI: Po çka të them. Unë mendoj që e  
7 gjithë akuza që ka të bëjë me mu, por dhe mendoj që ndoshta  
8 janë procedurat e Dhomave të Specializuara, po këto procedura  
9 që janë ndjek nga mëngjesi i 4 nëntorit dhe deri këto të  
10 sotshmet, konsideroj që janë të papërshtatshme, them më së  
11 buti, janë të papërshtatshme për mua, për faktin se unë ndihem  
12 krejt i pafajshëm dhe asnjë arsye nuk ka pas që të jem këtu.

13 Po unë du ta tërheq edhe një varg. Ju e dini që për ish-  
14 Jugosllavinë ka qenë një Tribunal, dhe në Tribunalin e Hagës  
15 ka pas të akuzuar nga Kosova. Unë kam qenë dy herë dëshmitar  
16 në Tribunalin e Hagës, e kam thanë krejt atë çka kam pas ta  
17 them dhe po të kishte një dëshmi, një fakt të inkriminuar, unë  
18 jam i bindur që Gjykata Ndërkombëtare -- Tribunali  
19 Ndërkombëtar i Hagës do të më dënonte.

20 Do të thotë, unë e shoh këtë si përpjekje të fundit, dhe  
21 unë më vjen keq që ta them por duhet ta them, se në vitin  
22 2006, Akademia e Shkencave të Serbisë e ka bë këtë përpjekje  
23 që -- pasi ajo ishte pjesa kryesore e Tribunalit të Hagës, të  
24 ndërtojë një Tribunal edhe për Kosovën. Dhe ia arriti qëllimit  
25 duke krijuar një Tribunal krejt njëetnik, kur nuk besoj që ka

1 njeri, edhe njëherë po e përsëris, mbi 30-vjeçar që se din  
2 kush ka bë krime dhe gjenocid në Kosovë. Dhe kjo më dhemb dhe  
3 më dhemb shumë, se është padrejtësi e madhe. Po megjithatë,  
4 unë po i kuptoj ata njerëz edhe këta që janë këtu si sillen me  
5 mu. Mendojnë që dhe unë përme jam kriminal -- kriminel. Jo,  
6 unë jam intelektual. Jam arsimuar për me qenë mësues, por jam  
7 detyruar të luftoj kundër Serbisë. Ama ndaj njerëzve unë  
8 gjithnjë kam pas qëndrim njerëzor.

9 E thashë edhe njëherë po e përsëris, unë aq kaq të  
10 padrejtë sa më kanë bë sot prej burgut deri këtu, duke m'i  
11 lidh duart, duke më kontrolluar dhjetëra herë, unë kurrë në  
12 jetën time një njeri s'ia kam bërë.

13 Këtë po du me e theksu, se keni procedura që mund të jenë  
14 të përshtatshëm për kriminelë por jo për mu.

15 Prokurori dhe Prokuroria e dinë, se ata kanë marrë, i  
16 kanë marrë edhe librat që i kam shkru unë. Unë vërtet i kam  
17 shkru 15 libra edhe ndihem shumë mirë, po ndihem shumë keq për  
18 padrejtësinë, jo pak po tepër të madhe.

19 Edhe po e përfundoj. As kaq padrejtësi sa më keni bërë  
20 nga ora gjashtë e 4 dhjetorit //siç u tha// e deri më tani, se  
21 kam merituar. Edhe s'ka kush që as këtë padrejtësi mundet me e  
22 arsyetue.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Krasniqi.

24 Në fund, do të doja t'ju informoja që unë do të nxjerr  
25 një vendim që urdhëron Prokurorin e Specializuar dhe Zyrën e

1 Administratorit për të riklasifikuar dosjet e tyre në mënyrë  
2 që Mbrojtja të ketë akses në këto dosje sa më shpejt të jetë e  
3 mundur.

4 E ndërkohë që ju mbeteni në paraburgim z. Krasniqi, dua  
5 t'ju informoj që ju mund ta kundërshtoni ndalimin tuaj në  
6 paraburgim, në përputhje me rregullën 57. Kjo do të trajtohet  
7 me vendime me shkrim.

8 Ky është fundi i kësaj seance.

9 Do të dua të falënderoj palët edhe Administratoren për  
10 pjesëmarrësin e tyre. Dhe po ashtu më lejoni të falënderoj  
11 përkthyesit, stenografët, teknikët për audio -- për pjesën  
12 audiovizive dhe avokatin mbrojtës.

13 Këtu përfundon seanca. Faleminderit.

14 --- Seanca e Paraqitjes së Parë përfundon në orën 11.51

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25